



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:281257

Datë: 11.10.2024

Numri i dokumentit: 06288147

C.nr.939/15

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civile, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në çështjen juridiko kontestimore të paditësve A.A. dhe R.A. nga fshati Zhur, Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson av. E.G. nga Prizreni, kundër të paditurës Q.R.K - M.B., P.Zh.R - A.P.K. -Agjencia Pyjore e Kosovës- Drejtoria Kordinuese Rajonale me seli në Prizren, e përfaqësuar nga e autorizuar H.S.G. dhe avokati i përgjithshëm i shtetit, për shkak të kompensimit të dëmit material, duke vepruar sipas kërkesës së datës 30.08.2024 së paditësit A.A. nga fshati Zhur, Komuna e Prizrenit, të paraqitur përmes të autorizuarit të tij av. E.G. nga Prizreni mbi shfuqizimin e masës së sigurisë, me datë 11 tetor 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

SHFUQIZOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.939/15 të datës 22.10.2015, me të cilin është caktuar masa e sigurimit.

A r s y e t i m

Pranë kësaj gjykate paditësit A.A. dhe R.A. nga fshati Zhur, Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim i përfaqëson av. E.G. nga Prizreni,, ka parashtruar padinë kundër të paditurës Q.R.K - M.B., P.Zh.R - A.P.K - Drejtoria Kordinuese Rajonale me seli në Prizren, e përfaqësuar nga e autorizuar H.S.G. dhe avokati i përgjithshëm i shtetit, për shkak të kompensimit të dëmit material, me propozim për caktim të masës së përkohëshme të sigurimit.

Gjykata Themelore në Prizren me aktgjykimin me C.nr.939/2015 të datës 01.12.2017, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditesve, ndërsa me aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.877/18 të datës 29.05.2019, janë hedhur poshtë si të palejuara ankesat e paditësve A.A. dhe R.A. të prashtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.939/2015 të datës 01.12.2017, për shkak se të njëjtit e kanë tërhequr ankesën e parashtruar. Me anë të aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës REV.nr.292/2019 të datës 18.11.2019, janë hedhur si të palejuara revizionet e paraqitura nga ana e Avokaturës së Shtetit dhe nga ana e zyrës juridike të

të paditurës të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.877/18 të datës 29.05.2019.

Paditesi A.A. përmes të autorizuarit të tij av. E.G. nga Prizreni, me datë 30.08.2024, pranë kësaj gjykate ka parashtruar kërkesën për shfuqizimin e masës së sigurisë e cila është caktuar me aktvendimin e Gjykata Themelore në Prizren.nr.939/15 të datës 22.10.2015.

Andaj gjykata nga shqyrtimi i shkresave të lëndës C.nr. 939/15, më saktësisht aktgjykimit të datës 01.12.2017, me të cilin është vendosur meritoishtë mbi kërkesat e palëve në procedurë, si dhe aktvendimet e Gjykatave të shkallëve më të larta, me të cilat kanë konfirmuar plotëfuqishmërinë e aktgjykimit të shkallës së parë, erdh në përfundim se aktvendimi me të cilin është caktuar masa e sigurisë, C.nr. 939/15 i datës 22.10.2015, e ka humbur fuqin ligjore për të mbetur në fuqi.

Andaj gjykata duke pas parasysh të lartcekurat, ka marrë aktvendim mbi shfuqizimin e masës së sigurisë, pasi që i njëjti është pa fuqi ligjore, në kuptim të nenit 309 par 1 të LPK-së, sipas të cilit " ... Masa e sigurimit e caktuar me vendim të gjykatës mbetet në fuqi deri sa mos të jepet vendim tjetër mbi masën e sigurimit." . Ndërsa në rastin konkret aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.939/2015 të datës 01.12.2017 është bërë i plotfuqishëm me anë të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.877/18 të datës 29.05.2019.

Nga arsyet e cekura më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të nenit 309 par 1 të LPK .

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.939/15, datë 11 tetor 202

Gjyqtari

Shyqri Hoxha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.